

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Flamingot çfarë janë sot; lëvizje apo revolucion?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/flamingot-cfare-jane-sot-levizje-apo-revolucion-i587340
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 18:24:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 18:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	256a6bf67966a2b5c026b00d570dcad63b82253024c13c9c20ee2e4c88a3733d
TEKSTI	b6fa2e29cf4e09e860d94a77a55d0e56a10a6991fe0d68dbfc1b417a10d725f3
PAMJA	9b54b26f1ecf1f22633403f7d189afae8044b561c39730386770023cd5cd68ce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f3451cc022a91e02116eb0aecbf72bb271692cc6e8936449919dfcca7064c290
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e177be5550b4bd5f7d602f1900530a2156b51a950cd15b25e46c1bef83200b8c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f3451cc022a91e02116eb0aecbf72bb271692cc6e8936449919dfcca7064c290>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

—

English

—

ie Flamingot çfare jane sot; levizje apo revolucion?HaradinaJ ngjitet ne majen e Rupes, valemjt flamurin e UCK-se i rrahk i renduar ne aksin Lezhe-Milot, radhe te gjata autor fundit

Flamingot çfarë janë sot; lëvizje apo revolucion?



20 Shtator 2026, 20:22Politika TEMA





Nga Ylli Pata

Nëse për protestat e flamingove të mos flitet në mediat ndërkombëtare, ato nuk e marrin vëmendjen e debatit publik. Përveç nëse ndonjë segment i protestës nuk bën bujë me ndonjë kërcënim për tu bërë nami në ditën e radhës.

Kjo ka arsye dhe nuk ka nevojë për ndonjë analizë të posaçme. Protestat nuk e kanë arritur të krijojnë protagonizmin dhe të drejtojnë debatin politik, edhe pse janë e vazhdojnë të jenë në plan të parë mediatikisht.

Edi Rama, e mazhoranca është kthyer në një përkrahës i fortë i flamingove, duke e venë kontekstin e kësaj proteste në një program politik të qeverisë së tij. Ndërkohë opozita kryesore dhe ajo e vogël ka vijuar të mëshojë kontestimin ndaj mazhorancës, sidomos në logjikën e hetimeve të SPAK.

Flamingot, në realitet nuk ishin një lëvizje, megjithatë u konsiderua apo u soll nga mediat ndërkombëtare si një revolucion politik.

Një revolucion i cili ishte vetëm një narrativë e axhendës anti-Trunp, paso e gjithë protesta nuk ka lidhje me një revolucion. i cili sjell në shoqëri një erë të fortë ndryshimi e përmbysje jo vetëm në aspektin e elitës politike, por edhe mënyrën e funksionimit të shoqërisë.

Revolucionet e 1968 apo të viteve 1974 sollën në Europë një koncept politik e shoqëror që shkundi të gjithë Europën nga aborti, e drejta e divorcit, të drejtat e tjera civile, referendumet, debate social që hapën, si dhe mënyra e ndryshme e të të bërit politikë, duke futur referendumet si koncept paralel me zgjedhjet, e peticionet vendore si një instrument për çështjet e mjedisit, arsimit, shëndetësisë apo shtetit social.

Flamingot nuk janë aspak një revolucion social apo politik, pasi deri tani nuk e kanë shkundur shoqërinë me atë që atë kërkojnë në këtë shoqëri. Shkundja më e madhe ka qenë për një problem që kanë mes tyre si protestues. Flamingot, nuk janë një revolucion pasi e braktisën kauzën e Zvërnecit, për të marrë një përfitim pragmatic, kur u pa që çështja nuk mori një pëqlim të përgjithshëm. Nga ana tjetër, flamingot nuk janë një lëvizje politike, pasi deri tani nuk janë

kuidesur për ta krijuar një të tillë

E cila do të shtronte rrugën edhe për një revolucion të elitës politike.

Protestat megjithatë kanë dhënë shkundje në opinion, por çështja është te produkti i tyre, i cili më shumë u dëmtua nga një logjikë dritëshkurtër për të pasur një efekt të shpejtë, që po ra Edi Rama pastaj shohim e bëjnë. Kjo logjikë edhe pse mund të ketë një logjikë, në fund do të sillte sërish problemin e vizionit e fytyres. Ndaj dhe mazhoranca i kujton protestuesit se flamingot kanë ikur me kohë, duke i vizatuar pjesëmarrësit si pjesë e opozitës zyrtare. Që në fakt nuk është tamam kështu, por deri tani, bashkimi më i rëndësishëm i flamingove ka qenë pakti i madh ndërmjet Sali Lushës dhe Dritan Goxhajt....

TemA

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Shqipëria nuk shitet"/ Protestat në Tiranë, Rama për gazetën gjermane: Zakonisht jam më i mirë kur ndihem i sfiduar](#)

20:00 Politika / 5 komente

[Rama nis vizitën në SHBA nga Michigan-i: Takim me komunitetin shqiptar](#)

17:43 Politika / 26 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.